
STUDIES OF QEMAL MURAT IN THE FIELD OF TOPONYMY

Lonora Hysolli

University “FAN. S. NOLI” Korçë, Albania, lhysolli@yahoo.com

Abstract: Over the centuries, civilized nations and their respective states have placed paramount importance on language. Those who love their homeland and nation are always concerned with the preservation of the language. Among the many facts that testify to the preservation of language are also proper names. Toponymy deals specifically with the proper names of inhabited places, seas, lakes, rivers, streams, mountains, various types of reliefs, roads, squares, administrative divisions and regions. Research on place names is complex and filled with challenges, as toponyms are characterized by ancient origins, dating back to past epochs, and transmitted over time, often resulting in obscure forms. Toponymy aids both intra-linguistic and extra-linguistic disciplines. For linguists, research primarily appears as an interdisciplinary collaboration. Within this complex discipline, valuable linguistic contributions have been made by Albanian linguists both within and beyond the borders of the Republic of Albania. The material presented in this paper comes as a synthesis of the research and evidence of the continuous scientific work of the linguist Qemal Murati, in conditions where Albanian toponymy in North Macedonia (RMV) has often experienced certain challenges. Qemal Murati is one of the most productive Albanian linguists of our time, with over 40 books published in monograph form and dozens of other works as a co-author, editor or reviewer. Thanks to his cultural formation, he managed to create the foundations in Prishtina: initially in high school, then through university and postgraduate studies, at the Faculty of Philology of the University of Prishtina, especially in the Department of Albanian Language and Literature. His research profile has repeatedly testified that he belongs to all Albanian lands, because for him “language is the ultimate homeland”. This implies the main theme of his scientific positions, considering language a treasure “that states keep buried in banks to guarantee their existence”. Prof. Dr. Qemal Murati is a deep expert on Albanian and several foreign languages. Through his studies, he has shed light on issues of comparative linguistics, especially between the languages of the Balkans, where he has clarified many aspects of intercultural and interlingua influences. He has made a valuable contribution to the field of sociolinguistics and dialectology for the multidimensional study of the Albanian-speaking area in North Macedonia, researching aspects of grammar, lexicon and ethnography, in relation to the entire Balkan area. The paper aims to provide linguistic arguments about the studies of Albanian toponyms in the area of North Macedonia that could potentially affect issues of Albanology. The methodology used in this study will be descriptive, with the specific aim of systematizing and presenting his research in the field of toponymy, in the interest of various domestic and foreign researchers, also serving as a reference for this field of study for the entire Albanian area, part of the Balkan Peninsula.

Keywords: RMV area, autochthony, standardization, toponymy, Albanian toponymy.

STUDIME TË QEMAL MURATIT NË FUSHË TË TOPONIMISË

Lonora Hysolli

Universiteti “FAN. S. NOLI” Korçë, Shqipëri, lhysolli@yahoo.com

Përmbledhje: Në rrjedhën e shekujve, kombet e qytetëruara dhe shtetet përkatëse i kanë dhënë gjuhës rëndësi të dorës së parë. Ai që do atdheun dhe kombin e vet shqetësohet gjithmonë për ruajtjen e gjuhës. Midis fakteve të shumta që dëshmojnë ruajtjen e gjuhës janë edhe emrat e përveçëm. Me emrat e përveçëm të vendeve të banuara, të deteve, liqeneve, lumenjve, përrenjve, maleve, llojeve të ndryshme të relieveve, rrugëve, shesheve, ndarjeve administrative dhe rajoneve merret posaçërisht toponimia. Kërkimet mbi emërvendet janë komplekse, të mbushura me vështirësi, pasi toponimet karakterizohen nga formimi i lashtë, që daton në epokat e kaluara, të transmetuara me kalimin e kohës, për rrjedhojë, shpesh të errëta. Toponimia ndihmon disiplina brendagjuhësore dhe jashtëgjuhësore. Për gjuhëtarin kërkimi shfaqet kryesisht si një bashkëpunim ndërdisiplinor. Në këtë disiplinë komplekse, mirëfilli gjuhësore, kanë dhënë kontribut të vyer edhe gjuhëtarë shqiptarë brenda e jashtë kufirit të Republikës së Shqipërisë. Materiali i paraqitur në këtë punim vjen si një sintezë e hulumtimit dhe evidentimit të punës shkencore të vazhdueshme të gjuhëtarit Qemal Murati, në kushte ku toponimia shqiptare në Maqedoninë e Veriut (RMV), shpeshherë ka përjetuar problematika të caktuara. Qemal Murati është një ndër gjuhëtarët shqiptarë më prodhimtarë të bashkëkohësisë, me mbi 40 libra të botuara në trajtë monografie dhe me dhjetëra vepra të tjera si bashkautor, redaktor apo recensues. Me formimin e vet kulturor, arriti t’i krijonte bazat në Prishtinë: fillimisht në gjimnaz, më

pas me studimet universitare dhe ato pasuniversitare, në Fakultetin Filologjik të Universitetit të Prishtinës, posaçërisht në Degën e Gjuhës dhe të Letërsisë Shqipe. Me profilin e vet studimor, ai ka dëshmuar vazhdimisht se u përket të gjitha trojeve shqiptare, sepse për të “*gjuha është atdheu i fundit*”. Kjo nënkupton kryefjalën e qëndrimeve të tij shkencore, duke e konsideruar gjuhën një thesar “*që shtetet e mbajnë të groposur në banka për të garantuar ekzistencën e tyre*”. Prof.dr. Qemal Murati është njohës i thellë i shqipes dhe i disa gjuhëve të huaja. Me studimet e veta ka hedhur dritë mbi çështje të gjuhësisë krahasuese, veçanërisht mes gjuhëve të Ballkanit, ku ka sqaruar shumë aspekte të ndikimeve ndërkulturore e ndërgjuhësore. Ai ka sjellë kontribut të çmuar në fushën e sociolinguistikës dhe dialektologjisë për studimin shumëpërmasor të arealit shqipfolës në Maqedoninë e Veriut, duke hulumtuar aspekte të gramatikës, leksikut dhe etnografisë, në përfaqje me të gjithë arealin ballkanik. Punimi synon të japë argumente gjuhësore rreth studimeve të toponimeve shqiptare në arealin e Maqedonisë së Veriut që mund të ndikojnë potencialisht në çështje të albanologjisë. Metodologjia e përdorur në këtë studim do të jetë ajo përshkruese, me qëllimin konkret për t’i sistemuar dhe prezantuar kërkimet e tij në fushën e toponimisë, në interes të studiuesve të ndryshëm vendas e të huaj, duke shërbyer edhe si referenca për këtë fushë studimore për arealin mbarëshqiptar, pjesë e gadishullit të Ballkanit.

Fjalë kyç : areal i RMV, autoktoni, standardizim, toponimi, toponimia shqiptare.

1. HYRJE

Toponimia shqiptare në Maqedoninë e ish-Jugosllavisë, por edhe sot në RMV, shpeshherë ka përjetuar problematika, të cilat lidhen kryesisht me çështjen e autoktonisë së shqiptarëve në këto troje të Ballkanit. Përpjekjet e para për standardizimin e emërvendeve në ish-Jugosllavi lidhen me Maqedoninë (Baliu, 2004:37). Sipas projektit të Komisionit Republikan të Maqedonisë, vendimet e të cilit shpejt do të bëheshin të ligjshme dhe të referueshme jo vetëm në administratën e përditshme, por edhe në tekstet shkollore, toponimet shumëgjuhëshe në Maqedoni duhet të shkruheshin, të shqiptoheshin dhe të përdroreshin vetëm në trajtën e gjuhës maqedonase, si: Shkup: Skopje, Tetovë: Tetovo, Ohër: Ohrid, Kërçovë: Kiçevo, Dibër: Debar, Manastir: Bitola etj. (Baliu, 2004: 43)

U shtuan përpjekjet nga të gjitha drejtimit për të ndryshuar situatën, sepse ishte koha që duhet ta vendoste historinë e vendeve dhe gjuhës së tyre në vendin e vet. Për këtë qëllim, Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve Shkup, në 3 qershor 2013 organizoi sesionin shkencor me temë: “*Toponimia shqiptare në Maqedoni*”. Kjo erdhi për dy arsye: së pari, mungesa e eksplorimit të duhur shkencor të kësaj teme; së dyti, sanksionimi me ligj i toponimisë shqiptare në Maqedoni që nga viti 2004. Në këtë sesion tepër të rëndësishëm dhe ende të veçantë në llojin e vet në Maqedoni, u mbajtën kumtesa nga studiues e gjuhëtarë të shumtë, në përshtatje me temën si:

Avzi Mustafa: “*Toponimia dhe mikrotoponimia e Rekës së Epërme*”, Xhemaludin Idrizi: “*Për etimologjinë e disa toponimeve të fshatrave të rrethit të Shkupit*”, Begzad Baliu: “*Toponimia shqiptare në Maqedoni në studimet onomastike*”, Asllan Hamiti: “*Toponimia dhe mikrotoponimia shqiptare në Maqedoni – dëshmi e autoktonisë*”, Izmit Durmishi: “*Vështrime fonetike mbi toponiminë e Pollogut të Epërm*”, Ismet Osmani: “*Toponimia e Dervenit të Shkupit*”, Mustafa Ibrahim: “*Ligjërimi popullor dhe ai zyrtar i disa ojkonimeve në rajonin e Prilepit, Dollnenit dhe Krushevës*”, Naim Halimi: “*Toponimia në rajonin e Kumanovës – dëshmi për autoktoninë e shqiptarëve*”, Berton Sulejmani: “*Përdorimi i toponimeve shqiptare në tekstet shkollore shqipe (1981 – 1989) të botuara në Maqedoni*”, Skënder Asani: “*Mbi disa emërtime të lagjeve të Shkupit në shek.XIX-XX*”, Besnik Emni: “*Toponimia kadastrale dhe popullore në fshatin Çellopek të Pollogut*”, Agron Salihu: “*Toponimia e fshatit Sllatinë të komunës së Tearcës*” dhe Zeqirija Ibrahim: “*Standardizimi administrativ i toponimisë shqiptare në Maqedoni*”. Mes tyre ishte dhe studiuesi shqiptar nga Tuhini, Qemal Murati, njohësi i thellë i shqipes dhe i disa gjuhëve të huaja.

Me studimet e veta ka hedhur dritë mbi çështje të gjuhësisë krahasuese, veçanërisht mes gjuhëve të Ballkanit, ku ka sqaruar shumë aspekte të ndikimeve ndërkulturore e ndërgjuhësore. “*Elementet e shqipes në gjuhët sllave jugore*” (1990), “*Bashkëmarrëdhëniet gjuhësore shqiptare- maqedonase*” (2007), “*Kërkime miksoglotike në arealet shqipe dhe ballkanike*” (2017) etj, janë botime që përbëjnë kontribut të rëndësishëm në fushën e studimeve albanologjike, por edhe të linguistikës krahasimtare. Me forcë argumentuese, ai mbron çështjen e statusit të shqipes në Maqedoni. Me të njëjtin pasion mbron edhe ruajtjen e shqipes standarde, mosbastardimin e saj nga fjalët e strukturat e huaja, por edhe nga format jonormative. Gjuhëtarë dhe studiues shqiptarë Rami Memushaj e ka quajtur Qemal Muratin “*gardian i shqipes*”.

Kontributi i tij në fushën e shkencës lidhet edhe me përfshirjen në mësimdhënien akademike në universitete. (Tetovë, Prishtinë). Profesori ka pasur e vijon të ketë veprimtari drejtuese shumë aktive. Ka organizuar një numër të madh konferencash shkencore. Ka marrë pjesë dhe ka referuar në simpoziume dhe konferenca shkencore në Prishtinë, Tiranë, Shkodër, Gjirokastrë, Korçë, Shkup, Ulqin, Ohër, Tetovë. Ka drejtuar ndër vite një sërë projektesh akademike, si dhe revista periodike shkencore, si: “*Gjuha shqipe*” dhe “*Studime Albanologjike*”. Ka botuar punime studimore në revistat: Gjurmime albanologjike, Gjuha Shqipe (Prishtinë), Jehona, Studime Albanologjike (Shkup), Gjuha jonë (Tiranë), Buletin Shkencor (Shkodër), Lemba (Ulqin), Makedonski folklor (Skopje, 2008), etj.

Studimet në fushë të onomastikës ai i ka filluar me *“Toponimia e katundit Tuhinë-Kërçovë”*, (“Përparimi”, nr. 3, Prishtinë, 1971, f. 251-255.) Për katër dekada me radhë albanologu i kësaj ane i formuar në Prishtinë do t’i dalë zot kësaj hapësire me kërkimet në terren dhe me vlerësimet e saj, me krahasimet ndërgjuhësore, po edhe me vlerësimin e studimeve rreth saj. Vepra të tij me karakter onomastik, mund të përmendim : “Apelativat toponimike në toponiminë e Kërçovës”, Prishtinë, (1979); “Dëshmime onomastike për autoktoninë e shqiptarëve në trojet e tyre etnike në Maqedoni” (1993); “Fjalor i shqipes truallsore të Maqedonisë” (1998); “Shqiptarët dhe Ballkani ilirik në dritën e emrave dhe të familjeve” (1999); “Kërçova – hulumtime linguistike, etnografike dhe folklorike” (2008); “Fjalor toponomastik i tërthoreve shqiptare të Maqedonisë me mbi 4300 topoleksema” (2008); “Kosova në toponime – Kontribut për një fjalor onomastik dhe etimologjik”; “Shqiptarët dhe shqipja në një botë emrash të përveçëm” (2014); “Eksplorime në hapësirat e shqipes - studime sociolinguistike, dialektologjike, onomastike, etnografike dhe folklorike në Maqedoninë e Veriut”, (Instituti Albanologjik, Prishtinë, 2020) etj.

Toponimet janë gjuhë, histori, gjeografi, psikologji, shenja të komunikimit.(Murati, 2015:41).Vëllimi *“Dëshmime onomastike për autoktoninë e shqiptarëve në trojet e tyre etnike në Maqedoni”* (1993), ndahet në dy pjesë: Toponomastika dhe Antroponomastika. Pjesa e parë përbëhet nga katër studime: “Autoktonia e shqiptarëve në dritën e onomastikës së sotme dhe historike”, “Emërtimet e vendbanimeve mesjetare shqiptare në truallin e Maqedonisë”, “Shënime toponomastike nga rrethina e Kërçovës” dhe “Shënime toponomastike nga tërthoret shqiptare të Maqedonisë”. Pjesa e dytë e vëllimit trajton tema nga fusha e Antroponimisë. Atë e përbëjnë dy studime: “Patronimikat shqiptare të sllavomaqedonasit” dhe “Emrat vetjakë - mesjetarë të shqiptarët e Maqedonisë në dritën e defterëve turke të shek. XV”. Studimet të tilla përfaqësojnë përgjigjen më të mirë të dijes shkencore maqedonase mbi baza të mirëfillta shkencore, si dhe një hulumtim të përqendruar sa në shtrirjen horizontale po aq edhe vertikale në fushë të toponimisë.

Kërkimet e tij të botuara në vëllimin *“Çështje të onomastikës shqiptare në truallin gjeografik të Maqedonisë”* përfaqësojnë tekste të thelluara shkencore për konferenca akademike, studime të përkushtuara për botime akademike dhe tekste të rastit për shtypin ditor, e mbështetur në një pasuri të madhe shembujsh të nxjerrë nga dokumentet e arkivave apo mbledhur në tërthoret shqiptare në Maqedoni. Majat e kërkimeve në kolanën studimore të tij , Qemal Murati i shënon me veprën *“Shqiptarët dhe Ballkani ilirik në dritën e emrave e të vendeve dhe të familjeve”*. Kjo vepër është edhe një përpjekje e studiuesit Murati, për për të sjellë të dhëna të tjera dhe për të kurorëzuar mendimin gjuhësor të dy shekujve të fundit mbi prejardhjen e popullit shqiptar e të gjuhës shqipe.

“Fjalori toponomastik i tërthoreve shqiptare në Maqedoni” mund të quhet njëra nga veprat më të veçanta të tij për disa arsye: 1. është një nga të paktat që ndjek traditën e mbledhjes së thesarit të trashëgimisë materiale e shpirtërore të popullit shqiptar në fushë të gjuhës a të folklorit; 2. është një nga veprat e kësaj natyre në zonën kontinentale të hapësirës shqiptare; 3. është e vetmja e këtij lloji për hapësirën shqiptare në Maqedoni; 4. është një model për sinteza shkencore monografike në fushë të gjuhësisë, sado që është evidentuar vetëm leksiku i përzgjedhur dhe jo i tëri, gjë që në përmasa të tjera historike nuk e dëshmon gjithë pasurinë leksikore të trojeve shqiptare. Prej përbërjes gjuhësore, historike, semantike, strukturës gramatikore e fonetike, të leksikut toponimik të këtyre tërthoreve shqiptare në Maqedoni mund të nxjerrim veçori gjuhësore e historike të tij. Fjalori toponomastik ka vlera të pallogaritshme etnolinguistike, kulturore, historike etj. (Murati, 2008:12). Prej *Fjalorit toponimik* të kësaj vepre nuk është vështirë të dëshmohet se pasuria onomastike e shqiptarëve në Maqedoni shtrihet në të gjitha nënsistemet e saj: antroponimi (antroponimi, patronimi) dhe toponimi (ojkonimi, oronimi, hidronimi, fitonimi, zoonimi etj). Sythi i fundit i kësaj vepre, me titull *“Albanizmat në nomenklaturën e onomastikës maqedonase”* dëshmon pikërisht për një pasuri gjuhësore të shqipes, e skajuar në onomastikonin maqedonas të një periudhe historike mjaft të gjatë, e cila sigurisht një ditë do të jetë strumbullar i një monografie të hapur të Qemal Muratit në fushë të ballkanistikës. Aty dëshmohet se shqipja edhe në fushë të onomastikës, jo vetëm ka marrë, po edhe ka dhënë gjallërisht.

Ai ka sjellë kontribut të çmuar në shumë fusha. Kjo duket edhe në fushën e sociolinguistikës dhe dialektologjisë, përmes studimit shumëpërmasor të arealit shqipfolës në Maqedoni, duke hulumtuar aspekte të gramatikës, leksikut dhe etnografisë, në përjasje me të gjithë arealin ballkanik. Sipërmarrje të tilla nënkuptojnë njohjen e thelluar të historisë së gjuhës, e cila shpalolet qartazi në vepra të karakterit onomastik. ITShKSh-Shkup, së voni ka ndërmarrë nismën që punimet studimore dialektologjike të viseve të RMV-së t’i botojë në disa vëllime të ndara sipas një tipologjie të përafërt gjeografike e gjuhësore, për të paraqitur gjendjen e shqipes së folur popullore në të gjitha arealet e Maqedonisë së Veriut, të realizuara në kapërcyellin e viteve 1914-1985. Përfshirja thaujse e të gjitha të folmeve shqipe në Maqedoninë e Veriut në 6 vëllime ka qenë një vepër e munguar deri më sot, prandaj ky projekt paraqet një hap të rëndësishëm për njohjen dhe studimin e ligjërimeve dialektore të këtij areali dhe do të jetë një ndihmesë e madhe për gjuhësinë shqiptare. Duke përvijuar hapësirat dialektore shqiptare në arealin e Maqedonisë së Veriut, vepra do të japë një tablo të përgjithshme të tipareve thelbësore dalluese të gjendjes së shqipes së këtyre dialekteve. (ITShKSh-Shkup, 2020 : 11). Ky projekt mban me meritë emrin e profesor Qemal Muratit në cilësinë e redaktorit të përgjithshëm. Duke çmuar e vlerësuar një tjetër nga kontributet më cilësore e voluminoze të tij, Prof.

dr. Bardhosh Gaçe në një vështrim shkencor analitik, bën një vlerësim të tillë: Vepra “*Eksplorime në hapësirat e shqipes- Studime sociolinguistike, dialektologjike, onomastike, etnografike dhe folklorike në Maqedoninë e Veriut*” e studiuesit Qemal Murati është një vepër e gjerë për çështjet gjuhësore dhe historike të shqipes në Maqedoni, parë në karakterin historik dhe bashkëkohor. Është një vepër e shkruar mbi kritere shkencore, bashkëpunuese dhe referenciale, që shkruhet një herë në jetë, e cila nuk mund të jetë e tillë nëse nuk ka profesionalizëm, nuk ushqehet nga dashuria njerëzore e autorit për atë që shkruan. (Murati, Q. 2020 : 32)

2. MATERIALE DHE METODOLOGJIA

Qëllimi i këtij punimi është të hulumtojë në studime e botime të këtij albanologu, i cili shquhet për sasi relativisht të konsiderueshme, por edhe larmishmëri të ideve e tematikave të prodhimeve e botimeve shkencore. Ai është një ndër gjuhëtarët shqiptarë më prodhimtarë të bashkëkohësisë, me mbi 40 libra të botuara në trajtë monografie dhe me dhjetëra vepra të tjera si bashkautor, redaktor apo recensues. Punimi ngre hipotezën nëse Qemal Murati është më tepër personalitet që i kushton rëndësi sasisë së produkteve të tij, apo është studiues i mirëfilltë që kërkon, mbledh, hulumton, analizon dhe interpreton shkencërisht faktet gjuhësore? Kjo hipotezë mbështetet nga gjetjet e studimeve e kërkimeve që ka botuar ai në lidhje me toponimet apo emërvendet shqiptare në RMV, të cilat janë mirëfilli studime albanologjike. A ndihmon ky punim evidentues dhe përshkruues në qartësimin e hipotezës?

Metodologjia e përdorur në këtë studim është ajo cilësore, përshkruuese, me qëllimin konkret për t'i sistemuar dhe prezantuar kërkimet e tij në fushën e toponimisë, në interes të studiuesve të ndryshëm vendas e të huaj, duke shërbyer edhe si referenca për këtë fushë studimore për arealin mbarëshqiptar, pjesë e gadishullit të Ballkanit. Kombinimi i metodave sasiore dhe cilësore është më i rekomandueshëm nga studiuesit sot pasi rrit shkallën e besueshmërisë (Matthews & Ross, 2010). Kombinimi i metodave sasiore me ato cilësore sipas Thomas (2003) përbëjnë një qasje të integruar. Metoda e përdorur gjatë kryerjes së këtij punimi do të ishte mirë të ishte ajo e një qasjeje të kombinuar midis metodave sasiore dhe cilësore. Kur themi sasiore, në rastin tonë kemi parasysh jo mbledhjen e të dhënave në terren, por hulumtimin në biblioteka, për të grumbulluar pothuajse gjithë veprat e botuara nga studiuesi Qemal Murati. Ndërsa, kur themi cilësore, në rastin tonë kemi parasysh hulumtimin tematik, përmbajtjen e veprave, njohjen e ideve dhe fakteve të marra në studim prej tij. Procedura e hulumtimit të botimeve të Qemal Muratit u krye në dy faza. Gjatë fazës së parë u krye hulumtimi i titujve të veprave të botuara nga autori, në bibliotekën shkencore të Universitetit të Korçës, por edhe në bibliotekat digjitale. Pas saj, u vu re se ai ishte studiues i gjithanshëm, por që spikaste tek fusha e toponimisë. Gjatë fazës së dytë u kryen hulumtimet sipas tematikës në fjalë dhe vlerësimin që i kanë bërë studiuesit e tjerë veprës së tij.

3. KUFIZIME

Studimi ynë pranon kufizimet e mundshme, që mund të lidhen me mospërfshirjen e gjithë veprës voluminoze të këtij autori në përshkrim, por ky punim nuk mund të jetë shterues, pasi qëllimi i studimit lidhet me karakterin e përgjithshëm e përshkruar të veprave të Muratit, kryesisht në studime toponimike. Në hapësira më të gjera kohore dhe në studime e botime të tjera, secila prej fushave ku ka punuar Qemal Murati mund të trajtohen më shterueshëm. Edhe fakti që ky punim ka kryesisht karakter përshkruar, cilësor, krijon kufizimet e veta. Kampionimi në terren, me studiues e shkencëtarë që e njohin mirë veprën e Muratit, do jepnin mundësi më objektive e më reale për vlerësimin e studimeve të këtij albanologu që lindi më 6 gusht të vitit 1955 në Tuhin të Kërçovës e që sivjet kremton 70-vjetorin e lindjes.

4. REZULTATE

Të dhënat e përfutura nga kërkimi dhe hulumtimi i studimeve të shumta në numër të Qemal Muratit, na vënë në dukje se vepra e tij nuk ka vetëm vlera numerike, por ai kontribuon cilësisht me arritjet e studimeve dhe përfundimeve të nxjerra nga kërkimet shkencore në literaturë e në terren, duke integruar më së miri kërkimet sasiore me ato cilësore. Në korpusin e veprave albanologjike të Qemal Muratit, si një nga dijetarët e çmuar të kohës sonë, përfshihen një varg gjurmimesh e hulumtimesh komplekse e sinkretike, të cilat dëshmojnë horizontin kulturor e shkencor të tij edhe në rrafshin ballkanik në të cilat ndriçohet trashëgimia kulturore e shqiptarëve përgjatë shekujve. Ky studiues e gjuhëtar ka bërë një punë kolosale edhe në leksikografi, duke hartuar fjalorë voluminozë në sfera të ndryshme, njëgjuhësh e dygjuhësh, kryesisht të tipit shpjegues. Ndër fjalorët kryesorë të hartuar prej tij janë: “Fjalor i shqipes truallsore të Maqedonisë” (1998), “Fjalori idiomatik shqip-maqedonisht” (2003), “Fjalor i fjalëve të rralla të përdorura në viset shqiptare të Maqedonisë” (2003), “Fjalor i sllavizmave në të folmet shqiptare të Maqedonisë” (2004), “Fjalor toponomastik i tërthoreve shqiptare të Maqedonisë me mbi 4300 topoleksema” (2008), “Fjalor i gabimeve gjuhësore – këshilla për t'u shprehur saktë dhe bukur” (2013), “Fjalor i fjalëve dhe shprehjeve nga trojet e shqipes në Maqedoni”, “Fjalor i medievet”, apo edhe veprën unike “Fjalor i fjalëve dhe shprehjeve të Kosovës - me mbi 16 mijë zëra, (Prishtinë 2018, botim i Institutit Albanologjik) që rrok përmasat e 1072 faqeve. “Ky

Fjalor thesar do të jetë vepër tjetër në mbërritjet e gjuhësisë shqiptare dhe do të përbëjë një mjet me rëndësi të veçantë për çdo studiues që merret me fjalën shqipe. Me përparësi do të shfletohet lënda e këtij fjalori sidomos nga leksikologët e dialektologët, po edhe nga ata që merren me hulumtimet për etimologjinë e shqipes dhe për një log edhe më të gjerë njerëzish, veçmas nga arsimtarët e gjuhës shqipe e të letërsisë shqiptare” – siç shprehet recensuesi Prof.dr. Gjovalin Shkurtaç (Murati, 2018: 15). Edhe vepra “Kosova në toponime – Kontribut për një fjalor onomastik dhe etimologjik”, prej mbi 1200 faqesh, në të cilën autori ka evidentuar një korpus të përfillshëm prej rreth 30 mijë topoleksemash, pa asnjë dyshim është një studim i thelluar që posedon cilësi shkencore, sepse ky vëllim nuk paraqitet si një regjistër i thatë shkencor.

Një kontribut vërtet i rëndësishëm për këtë temë të veçantë të kulturës shqiptare i studiuesit të njohur Qemal Murati është dhe botimi voluminoz “Eksplorime në hapësirat e shqipes – Studime sociolinguistike, dialektologjike, onomastike, etnografike dhe folklorike në Maqedoninë e Veriut”. Vepra është një përmbledhje hulumtuese, evidentuese, interpretuese, debatuese, shkencore dhe njohëse, që shkruhet rrallë. Duket se Qemal Murati është ekspert i fushës. Kjo cilësi realizohet prej tij pikërisht nga qëllimi dhe motivimi i brendshëm për t’i sjellë të vërtetat e vështira shqiptare në një mjedis interesant shtresimesh, faktesh e mbivendosjesh. Sipas Prof. dr. Bardhosh Gaçe në: “Areali etnogjuhësor shqiptar në një vështrim shkencor analitik”, -vlerësim për veprën e Qemal Muratit “Eksplorime në hapësirat e shqipes- Studime sociolinguistike, dialektologjike, onomastike, etnografike dhe folklorike në Maqedoninë e Veriut”, Qemal Murati është një personalitet i njohur i dijes jo vetëm në Maqedoni, por në rrafsh ballkanik e më gjerë, për shkakun e të marrit me tema të rëndësishme të kulturës dhe gjuhës shqipe, për shkakun e një konsekuence të vazhdueshme debatuese me nevojën për interpretimin drejt dhe shkencërisht të të vërtetave shqiptare në hapësirën ballkanike, për shkakun e tezës së njohur të shqipes si një gjuhë indoevropiane, një nga gjuhët e vjetra të Ballkanit dhe të Evropës dhe shumë çështje të tjera folklorike dhe të kulturës popullore shqiptare. Në këtë kuptim, vepra në fjalë vjen nën autoritetin e një studiuesi me akribi shkencore të njohur dhe të vërtetuar, e cila i shtohet punës shkencore shqiptare në përgjithësi. (Murati, 2020 : 21) Për shkak të kontributit të tij madhor, që në vitin 2003, është zgjedhur këshilltar shkencor në Institutin Albanologjik të Prishtinës.

5. DISKUTIME

Në rrethin e studiuesve apo gjuhëtarëve nga gjithë trevat shqipfolëse diskutohet nga një pjesë e tyre nëse Qemal Murati është më tepër personalitet që i kushton rëndësi sasisë së produkteve të tij, apo është studiues i mirëfilltë që kërkon, mbledh, hulumton, analizon dhe interpreton shkencërisht faktet gjuhësore? Kur mbledh, qoftë edhe jo në mënyrë shteruese botimet e tij, bie në sy një veçori e tij: Qemal Murati e shpenzon kohën e tij cilësisht, duke punuar me këmbëngulje e duke u marrë me studime të shumanshme për t’u dhënë lexuesve, filologëve, historisë së gjuhës, gramatikës historike, dialektologjisë, leksikografisë, folklorit e mbi të gjitha toponomastikës, lëndë dhe material të rëndësishëm njohës, por dhe mundësi për studime të mëtejshme e të thelluara. Ai e do gjuhën e nënës, bijtë të indoevropianishtes që në gjenezë, edhe në dialekt, me ngjyrat dhe timbrin e bukur të tij etnik, por sidomos në standard që përfaqëson unitetin e këtij kombi kaq me vlerë që gjallon prej shekujsh në trojet e Evropës Juglindore, në trojet e Gadishullit Ballkanik. Për mbrojtjen dhe ndërgjegjësimin mbi përdorimin e gjuhës shqipe në përgjithësi, ai ka botuar një numër të madh veprash, të cilat përbëjnë një kontribut të vyer në fushën e kulturës gjuhësore. Qemal Murati është vënë në anën e studiuesve, të cilët kanë mbajtur qëndrim të prerë për të mos ndërhyrë në modifikimin e standardit të gjuhës shqipe. Për këtë çështje ai ka bërë jo vetëm hulumtime, por edhe polemika të herëpashershme në shtyp, të cilat më vonë janë përmbledhur edhe në vepra të veçanta, të tilla si: “Drejt përdorimi i shqipes dhe kultura gjuhësore” (1996), “Kokrra urtësie për gjuhën” (2001), “Standardi gjuhësor dhe kultura e shprehjes” (2004), “Për shqipen standarde – përmasa komunikuese dhe kombëtare” (2009), “Manual i thënieve për gjuhën” (2011), “Gjuha shqipe në komunikimet publike – Ligjërimi mes zyrtares dhe sendërgji për përmbysje standardi e kthim dialekti” (2013), “Probleme aktuale të gjuhës së sotme shqipe” (2014).

6. PËRFUNDIME

Toponimia është pjesë e kulturës së një populli, ajo është pasqyrë dhe mjet njohës i historisë, gjeografisë si dhe I gjuhës dhe dialekteve të popullit. (Muçaj, 2022:9). Prandaj dhe qëllimi i këtij hulumtimi është nxjerrja në pah e rolit dhe kontributit që ka një studiues i fushave gjuhësore në historinë dhe kulturën e popullit të vet, por edhe bashkëjetesës së shëndetshme me popuj të gjuhëve e të kulturave të tjera, pa humbur identitetin dhe pa dëmtuar njëri-tjetrin, duke e bërë më domethënëse ekzistencën e secilit individ apo bashkësi shoqërore, etnike, gjuhësore, kulturore etj. Punimi ynë synon të japë kryesisht fakte dhe argumente gjuhësore rreth studimeve të toponimeve shqiptare në arealin e Maqedonisë së Veriut, të sjella nga Qemal Murati, që mund të ndikojnë potencialisht jo vetëm në çështje të albanologjisë, por edhe përtej saj. Jeta e profesor Qemalit është e ndarë mes Kosovës e Maqedonisë. Me profilin e vet studimor, ai ka dëshmuar vazhdimisht se u përket të gjitha trojeve shqiptare, sepse për të “gjuha është atdheu i fundit”. Kjo nënkupton kryefjalën e qëndrimeve të tij shkencore, duke e konsideruar gjuhën një thesar

“që shtetet e mbajnë të groposur në banka për të garantuar ekzistencën e tyre”. Bazuar edhe në studime të mëparshme në këtë fushë, por edhe gjatë këtij hulumtimi u evidentua se bibliografia e pasur e studimeve cilësore e të thelluara në fushën e toponimisë së trevave shqiptare në përgjithësi, si dhe të Kosovës e Maqedonisë në veçanti, e bëjnë Qemal Muratin një zë potencial me ndikim në çështjen e standardizimit të toponimeve në këto treva ballkanike, sidomos në RMV. Si përfundim, kërkimet dhe studimet e vazhdueshme mbi baza e metodologji shkencore bashkëkohore të Qemal Muratit në fushë të onomastikës dhe toponimisë, janë vlerëplotë dhe kanë sjellë kontributin e tyre konkret në standardizimin e toponimeve në RMV.

7. MIRËNJOHJE

Shpreh mirënjohjen personale dhe njëkohësisht falënderimet më të sinqerta për udhëheqësin tim shkencor në studimet doktorale Prof.as.dr.Albert Riska për mbështetjen e plotë që më ofron gjatë hulumtimeve, me materiale të përzgjedhura me kujdes, sugjerimeve dhe këshillave gjuhësore. Jam falënderuese edhe ndaj Prof.dr. Ali Jasharit për këshillimet shkencore dhe gjetjen e literaturës mbështetëse.

REFERENCA

- Baliu, B. (2004). Gjendja e toponimisë shqiptare në Ballkan. Prishtinë: Era.
- Çabej, E. (1958). Problemi i autoktonisë së shqiptarëve në dritën e emrave të vendeve. Tiranë: BUSHT, SSSH nr.2.
- Cacciafoco, F. C. (2023). Place Names, Approaches and Perspectives in Toponymy and Toponomastics. Retrieved from <https://www.cambridge.org/9781108490160>
- ITShKSh-Shkup. (2020). Dialektologji shqiptare, Të folmet shqipe të Maqedonisë së Veriut. Shkup: ITShKSh-Shkup.
- Muçaj, F. (2022). Toponimia e Çamërisë. Tiranë: Kristalina-KH, fq.9.
- Murati, Q. (2007). Bashkëmarrëdhëniet gjuhësore shqiptare-maqedonase. Tetovë: Universiteti Shtetëror i Tetovës.
- Murati, Q. (2008). Fjalor toponomastik i tërthoreve shqiptare të Maqedonisë. Tetovë: Universiteti Shtetëror i Tetovës.
- Murati, Q. (2015). Shqiptarët dhe shqipja në një botë emrash të përveçëm. Prishtinë: Instituti Albanologjik.
- Murati, Q. (2020). Eksplorime në hapësirat e shqipes - studime sociolinguistike, dialektologjike, onomastike, etnografike dhe folklorike në Maqedoninë e Veriut. Prishtinë: Instituti Albanologjik.
- Riska, A. (2022). Gjurme e apofonisë indoeuropiane në gjuhën shqipe. Tiranë: Kristalina-KH.
- Sulejmani, F. (2016). Toponimia e malësive të Tetovës. Prishtinë: Piramida.